

Letërnjoftimi i Komunës së

SHTIMES

2014

Maj, 2015




Fakte

- Të hyrat buxhetore të Komunës së Shtimes më 2014 kanë shënuar rritje prej 52 mijë euro në krahasim me një vit më parë.
- Në administratë komunale janë të punësuar 84 persona, apo një shërbyes civil për 334 banorë. Mesatarja në shkallë vendi është një shërbyes civil për 278 banorë.
- Në sektorin e arsimit janë të punësuar 465 persona, prej tyre 408 mësimdhënës. Në Komunën e Shtimes raporti nxënës/mësimdhënës është 35.1. Mesatarja në shkallë vendi është 29.9.
- Në sektorin e shëndetësisë janë të punësuar 102 persona. Raporti punonjës shëndetësorë/popullatë në Komunën e Shtimes është 275.5. Mesatarja në shkallë vendi është 282.7.
- Komuna e Shtimes gjatë vitit 2014 ka pasur 2,161 persona që janë llogaritur nën skemën sociale. Krahasuar me numrin total të popullsisë në këtë komunë del se në Shtime rreth 9,2% e popullsisë të ardhurat i bazojnë në skemat sociale.
- Në Komunën e Shtimes gjatë vitit 2014 janë regjistruar 113 biznese të reja.
- Gjatë vitit 2014 janë shuar 13 biznese, shumica prej tyre nga fusha e tregtisë.
- Kryetari i Shtimes Naim Ismaili (PDK) gjatë fushatës zgjedhore ka dhënë 17 premtime nga fushat e ndryshme. Deri në maj 2015, shkalla e realizueshmërisë së premtimeve është 23%, apo nën mesatare në shkallë vendi, e cila është 24%.

2 Qeverisja komunale


Komuna e Shtimes në zgjedhjet e fundit lokale (2013) në raundin e parë zgjedhor ka zgjedhur përsëri qeverisjen e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK). Kryetari aktual i Shtimes z.Naim Ismaili (PDK) ka fituar mandatin në raundin e parë të zgjedhjeve. Në raundin e parë në zgjedhje kanë votuar 12,340 apo rreth 51% qytetarë me të drejtë vote.

Grafikoni nr.1 Dallimi mes votave në raundin e parë



Zgjedhjet për Kuvend Komunal kanë nxjerr këtë përbërje: PDK 10 ulëse, LDK 5 ulëse, VV 2 ulëse, AAK-LDD 2 ulëse, LD dhe PD me nga një ulëse.

Grafikoni nr.2 Ndarja e ulëseve sipas partive në Kuvendin Komunal të Shtimes në bazë të zgjedhjeve 2013




Ekzekutivi komunal i Shtimes ka 8 drejtori.

3 Buxheti i Komunës së Shtimes

Më 2014, Komuna e Shtimes kishte buxhet prej 5.6 milion eurove, një rritje prej afro 40 mijë eurosh në krahasim me vitin 2013. Pjesa më e madhe e këtij buxheti shpenzohet për paga dhe mëditje për 651 të punësuarit në arsim, shëndetësi dhe administratë. Buxheti për investime kapitale është 1.4 milion euro, një rritje e lehtë në krahasim me dy vitet paraprake.


Grafikoni nr. 3 Buxheti total i Komunës së Shtimes dhe kategoritë kryesore buxhetore



Instituti GAP

Më 2014, të hyrat buxhetore të Komunës së Shtimes ishin afro 361 mijë euro. Të hyrat vetanake kanë shënuar rritje në krahasim me vitin 2013.


Grafikoni nr.4 Trendi i të hyrave vetanake të Komunës së Shtimes 2011-2015



Instituti GAP


Pjesa më e madhe e këtyre të hyrave ishte nga tatimi në pronë. Të hyrat nga tatimi në pronë përbëjnë afro 30% të të hyrave të përgjithshme.

Grafikoni nr.5 Kategoritë e të hyrave buxhetore




Në krahasim me komunitet tjera të cilat kanë numër të përafërt të popullsisë dhe territorit, Komuna e Shtimes ka arritur të mbledh më pak të hyra se sa, Malisheva, Istogu, Deçani, etj.

Grafikoni nr.6 Krahasimi i komunave për nga të hyrat nga tatimi në pronë



Sa i përket shpenzimeve për dreka zyrtare, telefona mobil, shpenzime për mëditje jashtë vendit, riparimi i veturave, kanë shënuar rënie të dukshme në krahasim me një vit më parë, përveç shpenzimeve për telefoni fikse ku ka pasur një rritje prej 1 mijë euro.

Grafikoni nr. 7 Shpenzimet për disa kategori buxhetore



Komuna e Shtimes gjatë vitit 2014 ka shpenzuar për energji elektrike rreth 53 mijë euro, apo 5 mijë euro me pak krahasuar me një vit më herët, për ujë janë shpenzuar 22 mijë euro apo 1 mijë euro më shumë sesa në vitin paraprak, kurse për mbeturina janë shpenzuar 58 mijë euro apo 7 mijë euro më shumë.


Grafikoni nr. 8 Shpenzimet komunale sipas kategorive dhe viteve



4 Të punësuarit në sektorin publik


Vitin 2014 Komuna e Shtimes e ka përmbyllur me 651 të punësuar në sektorin publik, dy më shumë se sa një vit më parë. Përgjatë këtij viti, janë punësuar dy shërbyes civil më shumë në kuadër të administratës.

Grafikoni nr.9 Numri i të punësuarve në sektorin publik në Komunën e Shtimes




Komuna e Shtimes ka të punësuar një shërbyes civil për 334 banorë. Në krahasim me komunat tjera, Komuna e Shtimes ka më pak të punësuar në administratën lokale, në krahasim me popullsinë që ka. Mesatarja në shkallë vendi është një shërbyes civil për 278 banorë.

Grafikoni nr.10 Raporti të punësuar në administratë për kokë banori




Në sektorin e arsimit janë të punësuar 456 persona, prej tyre 408 mësimdhënës. Në Komunën e Shtimes raporti nxënës/mësimdhënës është 35.1. Mesatarja në shkallë vendi është 29.9. Edhe në sektorin e arsimit, ashtu sikurse në shërbimin civil, Komuna e Shtimes ka të punësuar më pak staf se sa mesatarja në shkallë vendi.

Grafikoni nr.12 Raporti nxënës/mësimdhënës në Komunën e Shtimes



Në sektorin e shëndetësisë janë të punësuar 102 veta. Raporti punonjës shëndetësorë/popullatë në Komunën e Shtimes është 275.5. Mesatarja në shkallë vendi është 282.7.


Grafikoni nr.13 Punonjës shëndetësor për kokë banori



5 Ekonomia lokale


Në Komunën e Shtimes gjatë vitit 2014 janë regjistruar 113 biznese të reja, një numër më i madh se sa që ishin regjistruar në dy vitet paraprake. Pjesa më e madhe e bizneseve të regjistruara më 2014 janë biznese me fushë veprimtari tregtare.

Grafikoni nr.14 Llojet e bizneseve të reja të regjistruara më 2014



Gjatë vitit 2014 janë shuar 13 biznese, ky numër nuk ka ndryshuar nga viti 2013, por nëse e krahasojmë me vitin 2012, atëherë ky numër është rritur nga 8 në 13.

Grafikoni nr.15 Llojet e bizneseve të shuara më 2014



6 Premtimet

Instituti GAP ka monitoruar premtimet e dhëna nga z. Naim Ismaili gjatë fushatës zgjedhore 2013. Nga 17 premtimet e monitoruara, deri në maj 2015 z. Ismaili ka arritur të realizoj 23% të premtimeve. Mesatarja e premtimeve të realizuara për të gjitha komunat e Kosovës deri në Maj 2015 është 24%.

Grafikoni nr.16 Premtimet e Kryetari dhe shkalla e realizimit





Instituti GAP

Rr.Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Kati 2
+381 38 609 339

info@institutigap.org
www.institutigap.org
www.komunat.institutigap.org

